



PROGRAMI I SUKSESIT TË PRINDËRVE (PARENT SUCCESS PROGRAM) Reduktimi i detyrimeve ndaj qytetit të Nju-Jorkut me anë të trajtimit për varësinë nga droga

Fotografia është e një modeli të përdorur vetëm për qëllime ilustruese.

Nëse po merrni pjesë në një program të trajtimit të varësisë nga droga ose keni përfunduar një të tillë së fundi, mund të reduktoni detyrimin tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën me **deri në \$7,500**.

A vlejné këto dy pika për ju?

- 1 Keni detyrime të mbështetjes financiare për fëmijën ndaj Department of Social Services (DSS) të qytetit të Nju-Jorkut
- 2 Keni përfunduar një program ambulator ose rezidencial të trajtimit të varësisë nga droga më 1 dhjetor 2024 ose pas kësaj date, i cili është i certifikuar nga Zyra e Shërbimeve kundër Alkoolizmit dhe Abuzimit me Substancat e shtetit të Nju-Jorkut (New York State Office of Alcoholism and Substance Abuse Services, OASAS)

Nëse këto dy pika vlejné për ju, atëherë Office of Child Support Services (OCSS) në Qytetin e Nju-Jorkut mund të reduktojë detyrimin e përhershëm të mbështetjes financiare për fëmijën që i detyroheni DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut **me deri në \$7,500**.

Keni pyetje?

Referojuni Pyetjeve më të shpeshta (Frequently Asked Questions, FAQs) për më shumë informacion rreth programeve të kualifikueshme të trajtimit të varësisë nga droga: <https://nyc.gov/ocss-debt-reduction>.

Pyesni stafin e programit tuaj të trajtimit të varësisë nga droga rreth “Programit të Suksesit të Prindërve” të OCSS-së ose kontaktoni OCSS-në me email, fizikisht ose me postë. Vizitoni faqen <https://on.nyc.gov/contactocss>.